



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 103, datë 30.09.2015

MBI

**MIRATIMIN E NËNSHKRIMIT TË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT PËR
PROGRAMIN E TRAJNIMIT AFATGJATË TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL PËR
AKTUAR**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 18, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare“, të ndryshuar, nenit 244 të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Rregullores nr. 32, datë 28.05.2015 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Edukimit“, si dhe nenit 18, pika c) të Rregullores nr. 83, datë 29.06.2011 “Mbi marrëdhëniet financiare të punonjësve me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” me propozim të Qendres së Edukimit,

V E N D O S I :

1. Miratimin e Nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit për Programin e Trajnimit Afatgjatë të Kualifikimit Profesional për Aktuar.
2. Ngarkohet Qendra e Edukimit për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Enkeleda SHEHI

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF)

Rr. "Dora d'Istria", Nr. 10

Tiranë, Shqipëri

Institutit dhe Fakultetit të Aktuarëve (IFoA)

7th Floor Holburn Gate

326-330 High Holburn

London

WC1V 7PP

dhe

Shoqatës së Aktuarëve të Shqipërisë (SHASH)

Pallati i Kulturës, QTZHK, Nr.6

Tiranë, Shqipëri

(së bashku "Palët")

Me përjashtim të rasteve kur shprehet një synim i kundërt, referencat ndaj një klauzole ose një shtesë janë referencë për një klauzolë ose një shtesë të kësaj Marrëveshjeje.

Referencat në numrin shumës përfshijnë edhe ato në numrin njëjës dhe anasjelltas.

1. HYRJE

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) është një institucion publik i pavarur, i cili ushtron veprimtarinë në përputhje me Ligjin Nr. 9572, datë 07.03.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" (i ndryshuar). AMF është autoriteti që rregullon dhe mbikëqyr tregun e sigurimeve, tregun e pensioneve private, të letrave me vlerë dhe veprimtarive të tjera financiare jobankare, ashtu siç përkufizohet në legjislacionin përkatës. Qëllimi parësor i AMF është mbrojtja e interesave të konsumatorëve, ruajtja e qëndrueshmërisë, transparencës dhe sigurisë në tregun e sigurimeve, letrave me vlerë dhe pensioneve private suplementare. Aktiviteti i AMF karakterizohet nga profesionalizmi, transparenca dhe standardi i lartë i shërbimeve për të gjitha grupet e interesit.

AMF është përgjegjëse për rregullimin, mbikëqyrjen dhe licencimin e aktuarëve në vend. AMF nëpërmjet Qendrës së Edukimit ofron mundësinë për kualifikim profesional përpara licencimit dhe edukim në vazhdim, ndër profesionet e tjera, edhe për aktuarët.

Instituti dhe Fakulteti i Aktuarëve (IFoA) është Organizmi i vetëm profesional Mbretëror i licencuar në Mbretërinë e Bashkuar (MB), i cili i dedikohet arsimimit, zhvillimit dhe

rregullimit të profesionit të aktuarit në MB dhe kudo në botë. Si një organizëm profesional, i cili operon në interes të publikut, IFoA punon me punëdhënësit dhe grupet përkatëse të interesit për të inkurajuar dhe zhvilluar punonjësit e tyre aktuarë për të përparuar në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me shkencën aktuariale dhe zbatimin e saj si dhe promovimin e profesionit të aktuarit.

IFoA ka përgjegjësinë kryesore për të rregulluar anëtarët e saj që ushtrojnë profesionin e aktuarit.

Shoqata e Aktuarëve të Shqipërisë (SHASH) është një shoqatë jofitimprurëse, e cila ka për qëllim zhvillimin, përmirësimin dhe promovimin e profesionit të aktuarit dhe shkencave aktuariale, aplikimin praktik, si dhe zhvillimin profesional dhe trajnimin e aktuarëve në vend.

2. QËLLIMI

- 2.1 Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është krijimi i bazave të bashkëpunimit për programet e Trajnimit dhe Kualifikimit Profesional për Aktuar që lidhen me arsimimin e aktuarëve dhe mbështetjen e tyre për edukim në vazhdim në Shqipëri.
- 2.2 Zbatimi i dispozitave të kësaj Marrëveshjeje do të kryhet në përputhje me Nenin 244 të Ligjit Nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe Nenin 12 të Rregullores nr. 32, datë 28.05.2015 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Edukimit” si dhe ligjet, rregulloret dhe marrëveshjet në Mbretërinë e Bashkuar të cilat brenda kuadrit të burimeve përkatëse nuk do të jenë në kundërshtim me interesat publike të vendeve të Palëve respektive.

3. AFATI I MARRËVESHJES

- 3.1 Kjo Marrëveshje do të fillojë në muajin Shtator 2015 dhe (në varësi të përfundimit të parakohshëm në vijim të kësaj klauzole 3) do të vazhdojë deri më 31 korrik 2017.
- 3.2 Pa çënuar asnjë të drejtë ose mjet tjetër juridik që secila prej palëve mund të ketë, cilado Palë mund t’i japë fund kësaj Marrëveshjeje pa pasur përgjegjësi ndaj tjetrës nëse:
 - 3.2.1 zbatimi i përgjegjësi të secilës Palë sipas kësaj Marrëveshjeje vonohet, pengohet ose parandalohet nga Forca Madhore dhe kjo vazhdon për një periudhë prej 14 ditësh të njëpasnjëshme ose një total prej 14 ditësh në çfarëdo lloj periudhe prej 28 ditësh; dhe
 - 3.2.2 cilado prej palëve shkel detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje dhe nuk e riparon atë shkelje brenda 14 ditëve që nga marrja e njoftimit me shkrim nga Pala tjetër që kërkon riparimin.
- 3.3 Nëse një Palë informohet për një ngjarje të Forcës Madhore e cila çon ose mund të çojë në mos-përmbushje ose vonesë në përmbushjen e detyrimeve të saj sipas kësaj Marrëveshjeje do të njoftojë menjëherë palën tjetër dhe do ta informojë atë për periudhën që ajo mendon se kjo mos-përmbushje apo vonesë do të vazhdojë. Pala e prekur do të marrë të gjithë hapat e nevojshme për të lehtësuar efektin e ngjarjes së Forcës Madhore.
- 3.4 Secila Palë do të ketë të drejtë që t’i japë fund kësaj Marrëveshjeje duke i dërguar palës tjetër një njoftim paraprak prej jo më pak se 30 ditë për këtë qëllim.

Për qëllime të klauzolës 3:

“Forcë Madhore” do të thotë çdo ngjarje përtej kontrollit të arsyeshëm të palës së prekur (duke përfshirë çdo konflikt industrial që prek çdo palë të tretë, zjarr, përmbytje, fatkeqësi, rebelim civil ose luftë).

4. ROLI DHE PËRGJEGJËSITË

4.1 AMF

- 4.1.1 AMF në bashkëpunim me IFoA dhe SHASH (shtrirja e këtij bashkëpunimi është e parashtruar në këtë Marrëveshje) do të organizojë Trajnimin dhe Kualifikimin Profesional për Aktuarë (në vijim “Programi”).
- 4.1.2 AMF do të sigurojë ambientin për zhvillimin e leksioneve të moduleve përkatëse dhe procesin e provimit. Ajo do të jetë përgjegjëse për progresin e mirë të Programit.
- 4.1.3 AMF do të vendosë në dispozicion të ekspertëve Vullnetarë të propozuar nga IFoA të gjitha pajisjet e nevojshme (kompjuter, projektor power-point, tabelë me shfletosje, usb, materialet bazë, etj.), për të lehtësuar dhe asistuar ekspertët gjatë leksioneve. Mënyrat për transmetimin e testeve për vlerësim nga ana e ekspertëve vullnetarë do të jenë me email (të skanuara) ose me postë nëse nuk janë të lexueshme. AMF do të caktojë gjithashtu një person përgjegjës për të qenë i pranishëm dhe për të asistuar ekspertët vullnetarë gjatë leksioneve.
- 4.1.4 Për kohëzgjatjen e Programit, AMF do të jetë përgjegjëse për të gjitha kostot dhe shpenzimet në lidhje me ekspertët vullnetarë të propozuar nga IFoA për qëllime të Programit dhe sipas kësaj Marrëveshjeje, që përfshijnë shpenzime udhëtimi, ushqimi dhe akomodimi.

Për qëllime të klauzolës 4:

“Vullnetar” do të thotë individ i propozuar nga IFoA për të dhënë leksion modulet e këtij Programi, i cili nuk merr asnjë honorar për dhënien e leksioneve, por të gjitha kostot e tjera (udhëtimi, ushqimi dhe akomodimi) mbulohen nga AMF.

4.2 IFoA

- 4.2.1 IFoA në bashkëpunim me partnerët e saj do të punojë me AMF, për të krijuar që në fillim një platformë edukimi moderne dhe të përshtatshme, për të shërbyer si bazë për kualifikimin e ri aktuarial. Ajo do të zhvillojë dhe do t’i sigurojë AMF-së, materiale të përshtatshme mësimdhënieje për të mbështetur këtë platformë. IFoA do të përpiqet t’i dërgojë paraprakisht këto materiale tek AMF-ja të paktën një muaj përpara se të jepet çdo modul. Në fund, ajo do të përpiqet të kërkojë ndër anëtarët e saj, ekspertë Vullnetarë të përshtatshëm për të dhënë leksion këto module në ambientet e AMF dhe për të hartuar dhe vlerësuar materiale për provim me shkrim, për të vendosur kriteret e sistemit të vlerësimit dhe për të asistuar me kontrollin dhe vlerësimin e provimeve apo testeve të përfunduara.
- 4.2.2 Modulet e Programit për t’u dhënë leksion nga ekspertët Vullnetarë të propozuar nga IFoA janë:

Moduli 2 – Asetet
 Moduli 3 – Të dhënat dhe Sisteme
 Moduli 4 – Ekonomi
 Moduli 6 – Sisteme Financiare
 Moduli 7 – Modelet
 Moduli 9 – Menaxhimi i Rrezikut
 Moduli 11 – Menaxhimi Aktuarial i Sigurimit të Jetës
 Moduli 12 – Menaxhimi Aktuarial i Sigurimit të Përgjithshëm
 Moduli 13 – Menaxhimi Aktuarial i Pensioneve
 Moduli 14 – Praktika Personale dhe Profesionale
 Prezantimi i dizertacionit & ceremonia

Lista e plotë me lektorët e propozuar dhe të miratuar midis palëve për të gjithë Programin është bashkëngjitur kësaj Marrëveshjeje në Anex A. Kjo listë mund të jetë subjekt i ndryshimit, por gjithmonë pas miratimit paraprak nga palët.

- 4.2.3 IFoA do të jetë përgjegjës për modulën e Profesionalizmit dhe Programin vijues “Trajnimi i Trajnuesve” (nëse do të ketë).
- 4.2.4 IFoA nuk do të konsiderohet përgjegjës për çdo veprim dhe/ose mosveprim të ndonjë ekspertit vullnetar, të ndryshëm, sipas kuptimit të kësaj Marrëveshjeje
- 4.2.5 IFoA nuk do të konsiderohet përgjegjës në çdo kohë për çdo dështim për të siguruar ekspertë vullnetarë.
- 4.2.6 AMF siguron se nuk do të rëndojë IFoA për ndonjë pretendim, përgjegjësi, dëmtim, kosto dhe/ose shpenzim (duke përfshirë tarifat ligjore profesionale dhe shpenzime) të shkaktuara ose të paguara nga AMF gjatë Programit të cilat lindin ose janë në lidhje me këtë Marrëveshje.

4.3 SHASH

- 4.3.1 SHASH do të japë kontributin e saj duke dhënë leksione pa pagesë për Modulën nr. 10 të Programit – “Parimet & Praktika e Sigurimit të Jo-Jetës”. Ky modul nuk do të ketë asnjë kosto për AMF-në.

5. TË DREJTAT E PRONËS INTELEKTUALE

- 5.1 Të drejtat e pronësisë intelektuale (Background IPR) janë dhe do të mbeten, pronë ekskluzive e palës që i zotëron ato (ose ku aplikohet, e palës së tretë nga e cila ka rrjedhur e drejta e saj për t’i përdorur ato). Këto të drejta të pronësisë intelektuale mund të përdoren për qëllime të Programit mbi bazën e kushteve dhe afateve të rëna dakord midis Palëve.
- 5.2 IFoA i akordon AMF në emër të pjesëmarrësve të Programit, një licensë jo ekskluzive, të përhershme, pa komisione, të patransferueshme për të përdorur të drejtat e pronësisë intelektuale për qëllime edukimi që lidhen vetëm me këtë Program ose për qëllime të tjera me kusht që të ekzistojë një marrëveshje paraprake me shkrim ndërmjet Palëve.
- 5.3 Të drejtat e pronësisë intelektuale (Foreground IPR) me përjashtim të rasteve kur pranohet ndryshe me shkrim ndërmjet Palëve, do të jenë pronë e Palës që e ka krijuar, gjeneruar dhe/ose zhvilluar atë (“Krijuesi”). Krijuesi i akordon këtu një licensë jo ekskluzive, të përhershme, pa komisione, të patransferueshme Palës tjetër për të përdorur të drejtat e

pronësisë intelektuale për qëllime edukimi që lidhen vetëm me këtë Program ose për qëllime të tjera me kusht që të ekzistojë një marrëveshje paraprake me shkrim ndërmjet Palëve.

- 5.4 Klauzola 5 dhe detyrimet që rrjedhin prej saj do të vazhdojnë të jenë të zbatueshme pas skadimit ose përfundimit të kësaj Marrëveshjeje.

Për qëllime të klauzolës 5:

“Background IPR” nënkuptojnë të gjitha të Drejtat e Pronësisë Intelektuale (duke përfshirë edhe materialet bazë të IFoA), me përjashtim të atyre të Drejtave të Pronësisë Intelektuale, të cilat krijohen/shfrytëzohen gjatë Programit ose në lidhje me të;

“Foreground IPR” nënkuptojnë të gjitha të Drejtat e Pronësisë Intelektuale që lindin, fitohen, ose zhvillohen gjatë Programit ose në lidhje me të.

“Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale” nënkuptojnë të drejtat e pronësisë intelektuale kudo që lindin nëpër botë, të regjistruara ose të paregjistruara (dhe duke përfshirë çdo aplikim), duke përfshirë të drejtën e autorit, kompetencat profesionale, informacionet konfidenciale, sekretet tregtare, emrat e biznesit dhe emrat e domaineve, markat tregtare, markat e shërbimeve, emrat tregtarë, patentat, patentat e vogla, modelet e përdorimit, të drejtat e dizajnit, të drejtat topografike gjysmë-drejtuese, të drejtat e bazës së të dhënave dhe të gjitha të drejtat në natyrën e të drejtave të konkurrencës së padrejtë ose të drejtat për të paditur për heqje dorë.

6. LIRIA E INFORMACIONIT DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE

- 6.1 Pranohet se Palët janë ose mund të jenë subjekt i Kritereve Ligjore që lidhen me lirinë e informacionit dhe do të asistojnë dhe bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për t’u mundësuar Palëve që të jenë në përputhje me të gjitha kriteret për dhënie informacioni shpjegues.
- 6.2 Në rast se cilado prej Palëve merr një kërkesë për dhënie informacioni shpjegues në lidhje me Programin, ose në lidhje me këtë Marrëveshje, ajo do të bëjë përpjekje të pranueshme për të njoftuar dhe për t’u konsultuar me Palët e tjera dhe do të marrë në konsideratë këndvështrimet e Palëve të tjera përpara dhënies të informacionit të kërkuar. Palët e kësaj Marrëveshjeje pranojnë se ato mund të jenë të detyruara që të japin informacione shpjeguese në vijim të konsultimit dhe pasi kanë marrë parasysh këndvështrime të caktuara.
- 6.3 Palët pranojnë se ato do të veprojnë në përputhje me detyrimet e tyre sipas Kritereve Ligjore të duhura për mbrojtjen e të dhënave në juridiksionin e tyre përkatës, kur përpunojnë të dhënat personale në emër të Palës tjetër.
- 6.4 Klauzola 6 dhe detyrimet që rrjedhin prej saj do të vazhdojnë të jenë të zbatueshme edhe pas skadimit ose përfundimit të kësaj Marrëveshjeje.

Për qëllime të klauzolës 5:

"Kritere ligjore" nënkupton çdo legjislacion dhe/ose të drejtë zakonore ose ndonjë pjesë të saj, duke përfshirë pa kufizim çdo legjislacion vartës dhe çdo akt legjislativ të Shqipërisë, Mbretërisë së Bashkuar, Bashkimit Evropian apo Komisionit të Komunitetit Evropian i cili pa miratime të mëtejshme ka efekt ligjor në Mbretërinë e Bashkuar.

7. ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE & LIGJI QË ZBATOHET

- 7.1 Palët bien dakord këtu që nëse cilado prej Palëve ka një konflikt që lind nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje, atëherë:
- 7.1.1 Përfaqësuesit kryesorë nga secila prej Palëve do të angazhohen dhe do të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në mirëbesim dhe me synimin për të bërë përpjekje që të zgjidhin konfliktin (**“Faza e Parë”**);
 - 7.1.2 Në rast se konflikti nuk zgjidhet në Fazën e parë, Drejtorët e Përgjithshëm Ekzekutivë ose ekuivalentët e tyre tek secila Palë do të angazhohen dhe do të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në mirëbesim dhe me synimin për të bërë përpjekje që të zgjidhin konfliktin (**“Faza e Dytë”**);
 - 7.1.3 Në rast se Faza e Dytë nuk është e suksesshme dhe konsiderohet si e tillë nga secila prej Palëve në zgjidhjen e konfliktit, Palët bien dakord që të procedojnë për ndërmjetësim në përputhje me procedurat ligjore të të dyja vendeve për ndërmjetësim. Ndërmjetësimi do të drejtohet nga një ndërmjetës i vetëm i caktuar nga Palët. Ndërmjetësimi nuk do të çenojë të drejtat dhe kompensimet e Palëve në asnjë prej procedurave të ardhshme.
- 7.2 Kjo Marrëveshje, në të gjitha aspektet, do të shpjegohet dhe interpretohet dhe do të ketë fuqi në përputhje me ligjet e të dyja vendeve, dhe nëse ka ndonjë konflikt midis së drejtës së vendit, ajo do të interpretohet në përputhje me ligjet e Anglisë dhe Uellsit.

8 TË DREJTAT E PALËS SË TRETË

Kjo Marrëveshje lidhet për përfitimin e Palëve dhe nuk ka për qëllim që të përfitojë ose të zbatohet nga asnjë person dhe/ose subjekt tjetër.

9. NJOFTIMET

Një njoftim i dhënë në kuadër të kësaj Marrëveshjeje do të dërgohet në vëmendje të personit dhe në adresën e dhënë në këtë klauzolë 9 (ose një personi ose adrese tjetër pasi pala marrëse të mund të ketë njoftuar palën tjetër) dhe do të dërgohet me postë ajrore të para-paguar, të klasit të parë ose me postë rekomande. Adresat për shërbimin e njoftimit janë:

për IFoA-në:

Neil Hilary

Aktuar

7th Floor Holburn Gate

326-330 High Holburn

Londër

WC1V 7PP

Për AMF-në:

Znj. Ornela KULLOLLI

Drejtor, Qendra Edukimit

Rr. Dora d'Istria, Nr. 10
Tiranë, Shqipëri

Për SHASH-në:

Z. Llukan PUKA

President Nderi

Pallati i Kulturës, QTZHK, Nr.6

Tiranë, Shqipëri

10. MARRËVESHJA NË TËRËSI

Kjo Marrëveshje përbën marrëveshjen në tërësi ndërmjet Palëve në lidhje me temën dhe shfuqizon dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet ose anganzhimet paraprake të mëparshme ndërmjet palëve, verbale ose me shkrim, në lidhje me të.

11. TË NDRYSHME

Palët bien dakord që të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për lëshimin e çertifikatës së përbashkët në fund të programit.

Kërkesat në lidhje me këtë Marrëveshje do të bëhen me shkrim në gjuhën angleze drejtuar personave të kontaktit të shënuar në listë në Aneks B.

Për dhe në emër të
Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

Për dhe në emër të
Institutit dhe Fakultetit të Aktuarëve

Znj. Enkeleda SHEHI

Dr. Trevor Watkins

Drejtore i Përgjithshëm Ekzekutiv

Drejtore Edukimi

Për dhe në emër të
Shoqata e Aktuarëve të Shqipërisë

Z. Llukan PUKA

President Nderi

Aneks A

PROGRAMI

Modul 1	Matematikë, Lektor: Prof. Llukan Puka, 14 – 18 shtator 2015
Modul 8	Statistikë, Lektor: Prof. Llukan Puka, 9-13 nëntor 2015
Modul 2	Asete, Lektor: Z. Pankaj Tewari, 07 – 11 dhjetor 2015
Modul 4	Ekonomi, Lektor: Annie Kennedy, 11-15 janar 2016
Modul 5	Finance, Lektor: Doc. Alban Korbi, 15-19 shkurt 2016
Modul 6	Sisteme Financiare, Lektor: Martin Stafford, 14-18 mars 2016
Modul 7	Modelet, Lektor: Ian Rogers, 11-15 prill 2016
Modul 3	Të dhënat dhe Sistemet, Lektor: Mark Shimmons, 16-20 maj 2016
Modul 9	Menaxhimi i Rrezikut, Lektor: Martin Balleer, 13-17 qershor 2016
Module 10	Parimet dhe Praktika e Sigurimit të jo-Jetës, Lektor: Juliana Dengeri & Etjon Basha (SHASH), 12-16 shtator 2016
Modul 11	Menaxhimi Aktuarial i Sigurimit të Jetës, Lektor: Andy Whitehouse, 10-14 tetor 2016
Modul 12	Menaxhimi Aktuarial i Sigurimit të Përgjithshëm, Lektor: Henry Yan, 21-25 nëntor 2016
Modul 13	Menaxhimi Aktuarial i Pensioneve, Lektor: Sally Calder, 16 -20 janar 2017
Modul 14	Praktika Personale dhe Profesionale, Lektor: Neil Hilary, 20-24 shkurt 2017
Prezantimi dhe mbrojtja e dizertacionit: mars/prill 2017	

Aneks B

Kontaktet Kryesore

Kontaktet kryesore të përcaktuar për komunikim dhe shkëmbim të informacioneve ndërmjet Palëve, siç parashtrihen në këtë Marrëveshje janë si vijon:

Për AMF

Rr. Dora d'Istria, Nr. 10
Tiranë, Shqipëri

Znj. Ornela KULLOLLI
Drejtor, Qendra Edukimit

Tel: +355 4 2 251 355/ext. 141
Faks: +355 4 2 250 686
E-mail: okullolli@amf.gov.al
www.amf.gov.al

Për IFoA

7th Floor Holborn Gate, 326-330 High Holborn
Londër, WC1V 7PP

Z. Neil Hilary
Aktuar

Tel: +44 (0) 20 7632 1456
Fax: +44 (0) 20 7632 2111
E-mail: neil.hilary@actuaries.org.uk
www.actuaries.org.uk

Për SHASH

Pallati i Kulturës, QTZHK, Nr.6
Tiranë, Shqipëri

Z. Etjon BASHA

Sekretar

Cel: +355693746454
E-mail: etjon.basha@actuaries.org.al
<http://www.actuaries.org.al>